



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -I- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 JANAR 2021**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:50.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Hysni Gërguri, Shpëtim Zhegrova dhe Fitim Halili.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 32 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-shprehu, shqetësimin dhe keqardhjen e tij që në rastin e përrurimit të objektit të ri të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, nuk janë ftuar anëtarët e kuvendit të komunës, kjo nuk është një gjest dhe hije e mirë për institucionin e Komunës. Pastaj ai iu uroj suksese të gjithë kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës dhe ftoj qytetaret e Komunës së Vushtrrisë që të përkrahen kandidatet tanë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-ngriti shqetësimin e punëtorëve të mirëmbajtjes së stadiumit të futbollit “Ferki Aliu” të cilët që disa muaj ankohen se nuk kanë marrë paga, ai pyeti kompetentet se çfarë po ndodh me këta punëtor dhe se ata a do ti marrin pagat. Kërkoj përgjigje me shkrim nga Drejtoria për Kulturë.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit**-adresoj kërkesën e prindërve të fëmijëve të cilët zhvillojnë aktivitete sportive në palestrën sportive “Jeton Tërrstena Tota” në të cilën palestër nuk funksionon nxejja dhe kështu këtë fëmijë po ftohen. Andaj kërkoj që ky problem të rregullohet.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-sqaroi se tash më është aprovuar projekti për efikasitet të energjisë për palestrën sportive, ku do të mundësohet ngrohja e dritareve, do të ndryshohet ndriçimi, ndërrimi i dritareve, vendosja e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit. Ky projekt është

zhvilluar, dhe në pranverë pritet të zhvillohen procedurat e prokurimit nga Agjencioni për Eficiencë të Energjisë Elektrike në kuadër të Ministrisë së Financave, ku komuna ka aplikuar për këtë projekt ku bënë pjesë çerdhja dhe shkolla e fshatit Smrekonicë

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi që pika e Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike të shtyhet për mbledhjen e muajit mars apo prill, kjo për faktin se kjo temë është mjaft me peshë dhe duhet të analizohet deri në detaje. Pastaj ky material është mjaft voluminoz dhe koha për trajtimin e tij ka qenë mjaft e shkurtër.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se ky vendim për aprovimin e planit për rimëkëmbje ekonomike është i një rëndësie të veçantë, dhe konsideron që kjo temë duhet të futet në rend të ditës ashtu që të debatohet mandej gjatë debatit mund të merret një vendim i arsyeshëm. Pastaj ai vlerësoi se ky plan ka mjaft pika të forta që duhet shtyrë përpara, dhe kjo edhe për faktin se gjendemi në një krizë të madhe ekonomike për shkak të pandemisë.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit**- në emër të grupit kuvendar të LDK-së, dha mbështetjen që ky plan të futet në rend të ditës për shqyrtim.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-propozoi që pika e lidhur me propozim-vendimin për emërimin anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtrri, të futet në rend të ditës me emrat pa përkatësi partiake, pasi ashtu është e precizuar në ligj.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se debati dhe aprovimi i planit për rimëkëmbje ekonomike, është detyra më urgjente që ka aktualisht kuvendi i Komunës së Vushtrrisë. Kjo për faktin se jemi ballafaquar me krizën më të madhe ekonomike si pasojë e pandemisë, dhe se 5 % e bizneseve aktive kanë shuajtur aktivitetin e tyre dhe shuarja e bizneseve nënkupton humbje të vendeve të punës. Ky plan ka për synim ndryshimin e të menduarit dhe të vepruarit për ekonomin dhe për mënyrën e të bërit politikë. Andaj i ftoj të gjitha grupet politike në kuvend që ti japin mbështetje këtij plani.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se materiali për këtë pikë të rendit të ditës ka ardhur me vonesë dhe anëtarët e kuvendit nuk kanë pasur kohë të analizojnë këtë plan. Ai ceku se është që ky plan të aprovohet, por që duhet të analizohet mirë. Fakti që në plan thuhet që për katër vitet e ardhshme të ndalet investimi në infrastrukturë (asfalt) nuk është i qëlluar sepse nuk mund të veprohet kështu pa bërë një analizë të mirëfilltë.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se ndalja e investimeve në infrastrukturë sidomos në shtrimin e asfalteve nuk do të thotë se bëhet rimëkëmbja ekonomike. Ai vlerësoi se pasi që gjendemi në fundin e mandatit do të kemi ndërrim të përbërjes së strukturave udhëheqëse dhe më tej do të vendoset për çështjet e rëndësishme komunale duke përfshirë planin dhe investimet në infrastrukturë.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës**-tha se janë pro që të aprovohet plani për rimëkëmbje ekonomike, por që parimisht qysh në fillim të këtij procesi ishin pajtuar që në planë të inkorporoheshin 14 projekte, e që tani janë vetëm 14 propozime, të cilat nuk i plotësojnë kriteret për të qenë projekte në kuptimin e plotë të fjalës. Andaj ai propozoi që kuvendi të del me një qëndrim unanim që të kërkoj nga kompania që e ka hartuar këtë plan që ti hartoj në formë kompletet këto 14 projektet me të gjitha karakteristikat dhe specifikat e duhura dhe më pas të vjen ky plan për aprovim final.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se nuk kemi pasur pajtueshmëri me partneret e koalicionit lidhur me këtë plan. Por e vërteta është se masat e parapara në këtë plan dhe vetë aprovimi i këtij plani është i natyrës urgjente. Dhe se një nga këto masa është propozimi që të zbritet tatimi në pronë në masën prej 25 % për qytetaret dhe bizneset e Vushtrrisë, ky propozim në mënyrë urgjente

duhet të kaloj në Ministrinë e Financave për aprovim ashtu që të fillohet zbatimi i tij. Projektet e parapara në këtë plan janë të qëllimit strategjik që parashohin se ku do të jetë qyteti jonë pas dhjetë (10) viteve. Pastaj askush nuk ka ndërmend ti ndal investimet në sektorin publik, por në plan është shpjeguar se nuk do të ketë investim në asfalt nga buxheti komunal nga të hyrat vetanake. Kriza është e papresdant masat duhet të jenë adekuate. Nga të hyrat vetanke mendohet që bëhet lejimi që ato të destinohen në projektet e zhvillimit dhe të punësimit. Përmes këtij plani parashihet që rreth 400 të rinj të punësohen ose të paguhen nga pagesa e praktikës në punë. Planifikohet që të blihet një kredi duke mbuluar normat e interesit deri në 6.000.000 € për çdo vit, për start up, për grat dhe femrat dhe për bizneset e reja. Pastaj projekte me rëndësi të veçantë është ngrahetja e qytetit dhe gasifikimi. Ku me këto parashihet zbritja e koston së jetesë për qytetarët deri në 40 %. Tutje vlerësoi se ky plan nuk është i një partie politike, dhe i vjen shumë keq që një parti politike mban qëndrim kaq të ngurtë për ta shtyrë aprovimin e këtij plani. Ai u zoti se ky plan nuk do të silltet prapë në kuvend nëse i njëjti sot nuk kalon, andaj ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që ta përkrahin këtë dokument me rëndësi të veçantë për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se kryetari i komunës po ngutet, dhe është evidente se sa herë jemi ngutur për të marr vendimi kemi gabuara, dhe shkoqiti shembullin e fabrikës për përpunimin e peshkut në fshatin Gracë, ku ishin premtuar 400 vende pune. Ai konsideron se ky plan duhet të analizohet mirë dhe të vjen pastaj në kuvend për aprovim.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**-tha se si parti politike nuk është se janë kundër votimit dhe aprovimit të këtij plani, dhe shtoi se projektet e parapara në këtë plan duhet të detajohen dhe konkretizohen edhe me vlera financiare, ky plan duhet të korrigjohet dhe më tej të vjen në një mbledhje tjetër për aprovim.

*Në vazhdim, kryesuesi i kuvendit e hodhi në votim propozimin e anëtares së kuvendit znj. Bahrije Ademi-Murati, për shtyrjen nga rendi i ditës të Planit për Rimëkëmbje Ekonomike, propozim i cili mori 10 vota "për", të tjerët nuk morën pjesë në votim, kështu që propozim nuk kaloi.*

***Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 22 vota "për" 1 votë "kundër" të tjerat "abstenim" aprovoi këtë:***

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 30 dhjetor 2020;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2020;
4. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë;
5. Shqyrtimi i Raportit të performancës së komunave për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2020;
7. Shqyrtimi i Peticionit për adoptimin e banesës së banimit të përbashkët;
8. Të ndryshme.
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit për Rimëkëmbjen Ekonomike;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtri;
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me vërshimet në Komunën e Vushtrrisë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 30 dhjetor 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 30 dhjetor 2020.*

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 1 votë “abstenim” të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoj Raportin vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.*

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim vendosi me sa vijon:*

1. Me këtë vendim barten të hyrat vetanake në shumën 60,000.00€ në kategorinë e investimeve kapitale në programin Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (47024) në projektin 49561 Projektet në bashkëfinancim me donatorë.

2. Barten të hyrat vetanake në shumën 40,766.58 € në kategorinë e investimeve kapitale në programin Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural(47024) në projektin 90231 Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave.

3. Barten të hyrat vetanake në shumën 190,000.00 € në kategorinë Subvencione dhe transfere në programin Zyra e kryetarit (16024).

4. Shuma totale e mjeteve financiare të tejkaluar sipas planifikimit buxhetor për vitin 2020 është 290,766.58 €

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë;

5. Shqyrtimi i Raportit të performancës së komunave për vitin 2019;

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se në tri vitet e fundit të qeverisjes së tij performanca e komunës ka ardhur duke u ngritur në mënyrë të vazhdueshme dhe si rezultat i kësaj Komuna e Vushtrrisë ka fituar grantin mbi 1,000.000 €, të cilat janë shfrytëzuar për projekte që e kanë

përmirësuar jetën e qytetarëve, si projekti i fushave sportive në Dobërllukë, ai spostimit të kablllove në qytet, projekti i hapësirave publike në qytet dhe shesheve nëpër fshatra dhe shumë projekte tjera. Ai vlerësoi se kjo performancë nuk kishte mundur të arrihet pa angazhimin e secilit zyrtar të shërbimit civil në administratën e komunës të cilët i falënderoj përzemërisht. Në vitin 2019 Komuna e Vushtrrisë është vlerësuar ndër pesë komunat me performancë më të mirë nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe DEMOSI. Pastaj në performancë jemi vlerësuar maksimalisht nga GIZI bashkë me Ministrinë e Ambientit, dhe po ashtu në projektet tjera që jemi vlerësua mirë nga KDI-ja për transparencë më të lartë, e po ashtu edhe USAID që ka vlerësuar Komunën e Vushtrrisë në tri vitet e fundit si komunën më transparente dhe llogaridhënëse për sa i takon prokurimit publik. Në fund ai tha se nga raporti del se rreth 95 % e rrugëve të komunës sonë janë rregulluar me asfalt, andaj edhe për këtë është menduar me planin e rimëkëmbjes ekonomike që ti jepet hapësirë zhvillimit ekonomik dhe të fillohet të konturohet një metodë tjetër e të bërë politike sa i përket zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-tha se performanca e mirë e Komunës së Vushtrrisë është trashëguar nga qeveria e kaluar, dhe është mirë që ajo po vazhdon kësaj i gëzohemi të gjithë. Ndër të tjera si element që duhet punuar është përfaqësimi gjinor, e që sidomos është për keqardhje përfaqësimi gjinor në qeverinë komunale për faktin se ka pasur shumë premtime dhe qeveria ka dështuar në këtë pikë. Përfaqësimin gjinor duhet parë si kualitet e jo si numër apo sasi, kjo për faktin se kemi mjaft gra dhe femra që janë të zonjat të jenë në pozita udhëheqëse. Elementi tjetër që duhet të ketë përmirësim është tek arsimit para universitarë, kërkoj që të përkrahet më shumë Drejtoria e Arsimit me qëllim që të përmirësohet edhe më tutej infrastruktura shkollore.

**Pas debati, kuvendi me 30 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoj Raportin e performancës së komunave për vitin 2019.**

6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Raportin Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.*

7. Shqyrtimi i Peticionit për adoptimin e banesës së banimit të përbashkët;

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-propozoi që të themelohet një komision, mikst mes kuvendit dhe qeverisë komunale, i cili do të ketë për detyrë të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë dhe do të japin rekomandime si të ecet tutej në zgjidhjen e kësaj problematike, qoftë duke e futur në projektet e komunës, apo të përdoret Ligji për dhënien dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, duke bërë që të ndërtohet me bashkëfinancim një objekt i ri, në atë vend nëse konstatohet se objekti aktual nuk ka qëndrueshmëri statike.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se aktualisht ekziston një komision i komunës, dhe njoftoi se për këtë çështje ekziston një ligj special, i cili është ligji për bashkëpronësi në pronë e përbashkët.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se nëse ekziston një komision i tillë atëherë, kuvendi mund ta autorizoj komisionin e tillë që të veproj, ose mund të autorizohet qeveria komunale që akordoj një operator ekonomik për zbatimin e një ekspertize të jashtme, lidhur me qëndrueshmërinë e atij objekti.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se kuvendi duhet ti delegoj përgjegjësin tek drejtoria kompetente, dhe konsideron se vet drejtoria mund të realizoj një ekspertizë lidhur me këtë objekt,

pa shkuar në procedura tenderuese. Andaj ai propozoi që pika e parë e vendimit të jetë delegimi i përgjegjësive tek Drejtoria e Urbanizimit, pika e dytë të autorizohet Qeveria Komunale që menjëherë duke përdorur kontratat kornizë që i ka në dispozicion të intervenoj në sanimin e gjendjes në atë objekt.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-propozoi që të themelohet një komision i cili do të merret me konstatimin e gjendjes faktike, që lidhet me qëndrueshmërinë statike të atij objekti.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet peticioni i parashtruar në emër të Suada Plakollit, për adoptimin e banesës së përbashkët e cila gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit” Nr. 92 në Vushtrri.**

**2. I delegohen kompetencat dhe përgjegjësitë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe komisionit të kësaj drejtorie, që të ndërmarrë të gjitha veprimet në zhvillimin e procedurave për vlerësimin e gjendje faktike dhe të konstatoj qëndrueshmërinë statike të kësaj ndërtese. Ndërsa pas përfundimit të këtyre procedurave të hartoj raport të cilin duhet të i'a adresoj kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

**3. Autorizohet qeveria komunale, që të ndërmarrë veprimet e nevojshme, duke përdorur mekanizmat ligjor të kontratave kornizë që i ka në dispozicion, për rinovimin e kësaj ndërtese, duke sanuar gjendjen e rënd në këtë objekt.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe komisioni i drejtorisë.**

**5. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**8. Të ndryshme.**

**9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit për Rimëkëmbjen Ekonomike;**

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**-përsërit se nuk janë kundër që kjo plan të aprovohet, por janë që projektet e parapara në këtë plan të jenë të detajuara dhe të specifikuar me kosto financiare. Pasi që është një dokument i rëndësishëm së veçantë për komunën ai nuk duhet të përmbaj vetëm projekte ideore, por ato duhet të jenë konkrete dhe të detajuara.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se nga hulumtimet e bërë që janë evidentuar në raport del se si rezultat i pandemisë covid-19 nga dhjetori i vitit 2019 deri në shtator 2020 janë shuar 331 biznese dhe në tabelë janë evidentuar edhe fushat apo veprimtarit që u përkasin këtyre bizneseve. Kryesisht janë biznese të vogla dhe familjare që kanë qenë burim i të ardhurave për familjet tona. Kjo krizë po vazhdon të thellohet çdo ditë. Krahas masave që ka ndërmarr Qeveria e Kosovës, që janë të shumta dhe adekuatet, Komuna e Vushtrris ka aranzhuar një pako emergjente ndihmuese në vlerë prej mbi 250,000.00 €, ku janë ndihmuar 513 biznese me vlera financiare prej 300 deri 1500 €, mesatarja e përkrahjes së këtyre bizneseve ka qenë 420 € për këto biznese. Tani plani i

rimëkëmbjes ekonomike që sot i është paraqitur kuvendit është një tërësi e politikave të reja e një qasje të re e që përkon domosdoshmërinë për të iu përgjigjur sfidave të reja që kemi. Është një logjik e thjeshtë nëse veprohet ashtu siç është vepruar që njëzet vite do të kemi të njëjtën rezultat, por nëse tentojmë të ndryshojmë politika do të kemi rezultate më të mira. Janë tri elemente themelore të këtij plani të rimëkëmbjes ekonomike: e para moratorium katër vjeçar për asfalt. Është detyrë e tij themelore si kryetar i komunës që të ketë një plan se si të mëkëmbet ekonomia e Vushtrrisë. Rritjen e buxhetit të komunës e kemi të pamundur me të hyrat aktuale që i kemi edhe në nivel vendi, prandaj plani i ridestinitimit të buxhetit nuk parasheh rritej totale të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë por ridestinitim të atyre mjeteve nga projektet kapitale siç është asfalti, në projektet e punësimit, zhvillimit dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ajo çka është e rëndësishme tek destinimi i mjeteve për punësim është fakti se të rinjtë të cilët do të angazhohen do të bëjnë një përvojë në punë, ndërsa komuna do të mbuloj pagesën e pagesë minimale që është 170 €, e që mendohet që shifra e punësimit do të jetë prej 400 të rinjë dhe kostoja financiare e këtij projekti mendohet të jetë prej 400,000.00 €. Ndërsa me 400,000.00 € tjera të destinuar nga asfalti planifikojmë të blejmë një kredi për projektin për mbulimin e normave të interesit, ku do të kemi lirim të kapitalit financiare deri në 6 milion euro, ku në këto fondet do të kemi qasje start up, të rinjtë, bizneset e reja me një grejs-periudhë 1 vjeçare kjo me të vetmin qëllim që shmangies nga falimentimi i këtyre bizneseve. Pika e dytë me rëndësi e këtij plani është mjaft inovator është zbritja e tatimit në pronë në vlerë prej 25 % për qytetarët dhe bizneset. Nga raporti shihet se kemi të planifikuar 2.4 milion të hyra vetanake, që vijën nga taksat dhe tatimi në pronë, por nëse e zbrisim tatimin në vlerën 25%, kjo nuk do ta afektoj buxhetin vetanaka pasi do të ketë zero tolerancë ndaj atyre që nuk paguajnë tatim. Kjo krijon mundësi për një likuiditet më madh financiar për bizneset dhe qytetarët. Ndërsa pika e tretë e planit të rimëkëmbjes ekonomike është një master plan pesë vjeçar i investimeve publike që kanë për qëllim në radhë të parë lehtësimin e jetës së qytetarëve, uljen e kostos së jetesës dhe transformimin e qytetit të Vushtrrisë. Të gjitha vendit e rajonit e kanë gasin si mjetë për ngrohje dhe për ekonominë familjare dhe kostoja e përdorimit të kësaj lënde djegëse është 40% më e lirë, se sa aktualisht që e kime sot me energji elektrike. Këto projekte si: ngrohtorja, gasifikimi, dhe liqeni akumulues i Sllakocit dhe krijimi i hapësirave rkracionle në Shalë të Bajgores janë projekte që e transformojnë qytetin e Vushtrrisë, dhe krijon mundësi për investitorët edhe të brendshëm edhe të jashtëm. Në fund ai bëri thirrje që të lëmë anash inatet politike, dhe mos të merremi me debate shterpe e boshe por le të kthehemi diskutimit me fakte dhe shtyrjes përpara të projekteve për qytetarët, duke apeluar që në mënyrë unanime të përkrahët plani i rimëkëmbjes ekonomike.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se këto projekte që po i prezanton kryetari i komunës janë tipike për fushat elektorale, dhe ndoshta ka menduar që në mandatin e ardhshëm ti realizoj sepse tani gjendemi në fund të mandatit. Ai shprehu skepticizmin e tij se mundet një kryetar komune të mëkëmb një ekonomi të qytetit kur ajo ishte në këmbë por u rrëzua nga ana e tij.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-duke replikuar me parafolësin e tij tha se ai vetëm as nuk e rimëkëmb një qytet e sa nuk e rrenën, por e vërtet është se raporti i performancës tregon se komuna ka pasur ngritje të përgjithshme të gjithmbarshme gjatë qeverisjes së tij. Por përsërit se si kryetari i zgjedhur i komunës ka obligim të paraqes një projekt plan për rimëkëmbjen e qytetit të Vushtrrisë dhe në këtë relacion nuk ka rëndësi se kush do të jetë në krye të komunës, por e rëndësishme është zhvillimi i përgjithshëm i Komunës së Vushtrrisë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se nevojitet një konsultë e shefave të grupeve kuvendare për tejkualuar këtë pengës dhe shtroj pyetjen që të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme për aprovimin e këtij plani pasi ai të përpunohet më mirë nga ana e anëtarëve të kuvendit. Ai shtroj nevojën që

ky plan të aprovohet pasi që gjendje e ekonomisë nuk është e mirë dhe Vushtrria është prekur edhe nga vërshimet e fundit që kanë shkaktuar shumë dëme.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se është me rëndësi që ky plan të aprovohet sot, më pastaj e sheh si të pamundur që serish të sillen në kuvend, pasi kjo punë është bërë bashkë me partneret e koalicionit, dhe sot këtu ndahemi sa i përket kësaj çështje dhe për këtë i vjen shumë keq. Si kryetar i komunës ndihet jo mirë dhe në një pozitë të pavolitshme kur tani në këto momente krize të thyhet besimi i deri tashëm, por ai insiston që plani duhet të aprovohet qysh sot. Për më keq mos përkrahja e këtij plani sot, është tepër jo e përgjegjshme, kur dihet se kërkesa për këtë plan ka ardhur nga Drejtoria për Ekonomi e cila udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje, procesi është mbikëqyrur nga një komision profesional i komunës deri në hartimin final të këtij plani. Ai apelon që ky plan të përkrahet nga të gjitha grupet politike në kuvend duke përfshirë edhe partnerët e koalicionit.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se askush në kuvendin e komunës përpos kryetarit të komunës nuk është duke bërë fushatë. Por LVV-ja ka pritur që me këtë plan të sillen projekte konkrete, kanë ardhur projekte ideore. Nëse e bëjmë një kalkulim të thjesht del që një faqe e këtij plani ka kushtuar rreth 1200 € para të qytetarëve, dhe tani nga ky plan kanë dalë vetëm disa ide dhe asgjë konkrete.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës**-tha se inicimi i hartimit të këtij plani është bërë me vendim të kuvendit, hartimi i tij është tenderuar përmes procedurave ligjore ku edhe është caktuar kostoja. Por ajo se çka është e rëndësishme është fakti se nëse pagesa është bërë që të kemi 12 projekte të gatshme për ti aplikuar, por në të vërtetë ne nuk mund ti pranojmë 12 koncept-dokumente që janë paraparë në këtë plan. Pastaj sqaroi se drejtori i Drejtorisë për Ekonomi ka nënshkruar një dokument i cili do të kishte 12 projekte. Në momentin e tanishëm konsideron se nëse kryetari i komunës mund të garanton se kompania hartuese e këtij plani do mund ti ofronte këto 14 projekte Lëvizja Vetëvendosje do ta shtynte këtë çështje përpara. Në të kundërtën nëse kompania do të kërkonte pagesë shtesë për ato projekte një gjë të tillë nuk mund ta përkrahin. Ai ftoj anëtarët e kuvendi të reflektojnë mençur para marrjes së vendimit, pasi që paraja publike duhet të maksimizohet në vlerë për komunën dhe në dobi të saj.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se përkrahin plani për rimëkëmbje ekonomike të Vushtrrisë, kjo edhe për arsyen se edhe korrespondon me sloganin e PDK-së =Rimëkëmbje=. Pastaj shtoi se materiali është ardhur me vonës dhe rrjedhimisht nuk është përpunuar sa duhet por vetëm në pika kryesore. Andaj lidhur me këtë çështje ai propozoi që të formohet një komision i përbashkët kuvend-qeveri komunale të punohet në këtë drejtim deri në mbledhjen e ardhshme, ashtu që tu mundësohet grupeve kuvendare që ti dërgojnë me shkrim propozimet e tyre inovative. Në këtë relacion konsideron se komuna ka nevojë për një plan të rimëkëmbjes ekonomike, sepse ky plan vërtet ka pika të forta dhe të qëndrueshme që do të na bëjnë nder në vijimësi të implementimit të tyre, ftoj të gjithë ta përkrahin këtë plan.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se ky plan është i mirë për komunën, dhe se ata e dëshirojnë zhvillimin dhe mëkëmbjen e ekonomisë së komunës. Por megjithëkëtë, ata nuk mund ta përkrahin një plan i cili koston e ka 140,000.00 € ndërsa tirazhi i tij është 107 faqe me plane ideore, dhe pa asnjë projekt konkret. Ajo vlerëson se ndoshta është herët të flitet për ngrohtoren e qytetit, e cila nuk mund të realizohet me vite, kurse fshatrat gjithandej komunës, nuk kanë akoma ujë të pijes. Andaj propozimi i tyre që të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme ku do të trajtohet kjo temë me në detaje dhe duke u sjellë projektet të cilat ishin premtuar më herët.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se prezantimi këtij plani nga ana e kryetarit të komunës është fshatë tipik elektorale dhe tallej me anëtarët e kuvendit, pasi kjo është dëshmuar edhe më



herët. Hartimi i 14 projekteve me 140,000.00 € nuk mund të bëhet pasi kanë kosto ma të lartë, kjo tregon se realizimi i tyre në plan nuk do të ndodh kurrë.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** – theksoi se asnjëherë dorë e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të ngritet para se të vijnë ato projekte. Prandaj, ne e kemi interesin qytetar para së gjithash, ku ka qenë zotim i tyre me shkrim dhe gojor dhe me atë ide e kemi shtyrë përpara këtë projekt. Kur është diskutuar kemi thënë se po na bie shumë lirë, ku po 10 mijë po bie një projekt, plus edhe plani. Meqenëse nuk është ashtu, nuk do ta mbështesim. Ne kërkojmë edhe nga deputetët e LVV-së që të kërkohej seancë e veçantë, nëse kompania është e gatshme t'i bëjë projektet. Në momentet që projektet do të vijnë, ne do ta mbështesim. Nuk jemi për me na shit askush <dushk për gogla>

**Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së** – i uroi suksese kandidatëve për deputetë: Besim Muzaqit, Hysni Gërgurit dhe Adnan Lahut. Sa i përket zgjedhjeve të 14 shkurt, dihet fituesi, ajo është Lëvizja Vetëvendosje. Nëse mendoni se po bëjmë garë për të fituar ndonjë poen politik, kjo nuk qëndron.

Sa i përket dokumentit në fjalë, ne nuk jemi kundër projekteve, por vetëm le të na vijnë në projekte konkrete. Ndërkaq, lidhur me atë që e propozoi kryetari që të bëhet një memorandum mirëkuptimi për 4-5 vitet e ardhshme, mendoj që nuk është në kompetencën tonë. Këto janë projekte afatgjate që ne nuk mund t'i përkrahim, sepse nuk jemi të sigurt se a do të jemi asamblistë apo jo, apo a do të jemi gjallë apo jo, sepse jemi në kohën e pandemisë.

Ai pyeti zyrën ligjore se a kemi të drejtë t'i ndërrojmë vendimet për implementim, të cilat i kemi marrë në muajin shtator (lidhur me buxhetin), pasi që buxheti i komunës është një mini-ligj që jemi të obliguar ta respektojmë. Ai tha se në muajin qershor apo korrik kemi të drejtë ta bëjmë një rishikim të buxhetit. Kurse, sot me një kërkesë të dikujt, apo për fushatë elektorale apo interesa tjera bëjmë ridestitim të mjeteve, kurse ato që i kemi votuar vet (buxhetin) ku ka projekte për asfalte, kanalizime etj dhe na është thënë që si buxhet është i pranueshëm. Prandaj, është e pakuptimtë që sot të marrim një vendim dhe t'i ridestinojmë ato mjete.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KK-së** – është brengosëse mënyra e diskutimit për këtë dokument. Më shumë kemi diskutime për inati të njëri – tjetrit dhe partive politike. Nuk bëhet krijameti që dy parti që qeverisin bashkë kanë qëndrime të kundërta apo të ndryshme, sepse kështu e ka demokracia. Bile shumë gjatë ju ka shkuar këtyre dy partive që natyrshëm nuk janë aspak të ngjashme. Është shumë demokratike që jo të gjithë asamblistët e këtyre dy partive politike të mendojnë si kryetari apo nënkryetari i komunës, por duhet ta kenë bagazhin e vet politik që me vendos si të veprohet tutje.

I ftoj të gjithë asamblistët që të veprojmë në të mirën e qytetarëve pa menduar se cila parti e ka përgatitur këtë dokument dhe ta lejojmë që të zhvillohet demokracia.

Ajo tha se nuk vlerësohet një person në bazë të partisë politike (qoftë e vogël apo e madhe), por duhet të kemi kujdes ndaj personave që gjatë gjithë jetës njihen për atdhedashuri dhe për veprimtari qoftë para, gjatë dhe pas luftës. Pas luftës, veprimtaria e tij është e lidhur ngushtë me zhvillimin e këtij vendi dhe për të mirën e qytetarëve. Fjala është pikërisht për mënyrën se si kryetari i komunës dhe disa të tjerë iu drejtuan z. Nezir Klinakut. Një njeri me plot vlera dhe kontribut gjatë gjithë jetës së tij për aq sa e njohim të gjithë ne të tjerët.

**Ilmi Azemi, anëtar i KK-së** – tha se propozova që të formohet një komision miks prej 5 anëtarëve kuvend – qeveri komunale (3 nga kuvendi i komunës dhe 2 nga qeveri komunale), i cili do të rekomandonte propozim – ndryshimet e nevojshme, që disa çështje kanë nevojë të ndryshohen,

kurse disa çështje tjera janë të qëlluara për zhvillim e qytetit. Pas formimit të këtij komisioni, ne jemi të gatshëm ta votojmë në parim këtë pikë të rendit të ditës, kurse mbetet në kontinuitet që në muajin tjetër të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i pikave të caktuara që do të rekomandohen nga komisioni dhe nga të gjitha grupet kuvendare.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** – deklaroi se kompetencat e çfarëdo komisioni nuk mund ta detyrojnë kompaninë që të na i sjell projektet. E vetnja mënyrë që kompania të na i sjell projektet për të cilat është paguar është që ky plan mos të votohet. Në momentin që do të aprovohet ky dokument, kompania e konsideron si punë të kryer dhe ai 10% që nuk i është paguar duhet t'iu paguhet dhe kaq.

**Ilmi Azemi, anëtar i KK-së** – u shpreh se propozues i këtij dokumenti është kryetari i komunës, e jo kompania. Propozova formimin e një komisioni për qëllimin më të mirë që të përmirësohen disa çështje.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e KK-së** – tha se nuk po e ka të qartë se pse pas gjithë këtyre diskutimeve po krijojmë paqartësi për fund. Ne e kemi krejt çështjen te pagesa prej 140 mijë euro që i është bërë kompanisë, ku janë zotuar se do të sillen projektet konkrete, të cilat mund të implementohen menjëherë. Qëllimi ynë është kursimi i parasë publike. Ne nuk po e kundërshtojmë dokumentin, por po kërkojmë që të shtyhet për një seancë tjetër qoftë të rregullt apo të jashtëzakonshme që të sillen projektet.

**Agim Bregaj, anëtar i KK-së** – tha se e përkrah propozimin e Ilmiut për formimin e komisionit dhe propozoj që njëra nga anëtarët e komisionit të jetë edhe Bahrije Ademi Murati dhe të na jep sqarime se kujt t'i paguajmë e kujt jo.

*Kuvendi i komunës me asnjë votë “për”, 10 “kundër” votoi Planin e Rimëkëmbjes, i cili nuk kaloi.*

*Kuvendi i komunës pas votimit me 21 vota “për”, asnjë “kundër” aprovoj propozim-vendim lidhur me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike duke inkorporuar propozimin e anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi për formimin e komisionit:*

1. Me këtë vendim aprovohet Plani për rimëkëmbje ekonomike të Komunës së Vushtrrisë si rezultat i pandemisë COVID-19.
2. Obligohet Kryetari i Komunës – Qeveria Komunale që të ndërmerri masa për implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të nivelit qendror dhe organizmat tjerë vendorë dhe ndërkombëtar.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani për rimëkëmbje ekonomike i Komunës së Vushtrrisë si rezultat i pandemisë COVID-19.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Ilir Krasniqin.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Agim Bregajn.

**Ilmi Azemi, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Abdullah Vojvodën.

*Kuvendi i komunës me 21 vota “për”, votoi komisionin në këtë përbërje: Ilir Krasniqi, Agim Bregaj dhe Abdullah Vojvoda.*

1. Me këtë vendim themelohet komisioni mikst kuvend-ekzekutiv komunal lidhur me plotësimin e Planit për rimëkëmbje ekonomike të Komunës së Vushtrrisë si rezultat i pandemisë COVID-19, në përbërjen si në vijim:

- 1.1. Ilir Krasniqi, anëtar i kuvendit, PDK;
- 1.2. Agim Bregaj, anëtar i kuvendit LDK;
- 1.3. Abdullah Vojvoda anëtar i kuvendit NISMA –Socialdemokrate;
- 1.4. Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- 1.5. Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

2. Komsioni i cekur në pikën 1 të këtij vendim, ka për obligim të zhvilloj punimet në plotësimin e planit të lartcekur, duke i marrë me shkrim propozimet inovative të gjitha grupeve kuvendare të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

3. Komisioni në fjalë pas përfundimit të këtij procesi të marrje së ideve për projektet që do të inkorporohen në plan, do të i'a sjellë kuvendit Planin për rimëkëmbje ekonomike të Komunës së Vushtrrisë me plotësim-ndryshimet e bëra në mbledhjen e ardhshme.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërim të anëtarëve të komisionit të ndërmarrjes “Përparimi”.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Mehdi Bejtullahun.

**Lorik Maxhuni, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Ilmi Azemin.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KK-së** – propozoi për anëtar të komisionit Agim Bregajn.

**Në vazhdim kuvendit me votim të fshehtë vendosi me sa vijon:**

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit mori 22 vota;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit mori 21 vota;

Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit mori 11 vota;

Konstatohet se u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim, emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtrri, si në vijim:

- 1.1 Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit të komunës-PDK
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit të komunës-LDK

2. Komisioni Komunal i aksionareve, do t'i ushtroj detyrat dhe përgjegjësit e tij në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike si dhe Statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtrri.

3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve do të jetë i njëjtë me mandatin e tanishëm të kuvendit të komunës.

4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:55.

Bastri Duraku  
  
Procesmbajtës

Nasuf Aliu  
  
Kryesues i Kuvendit

